



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Prodato Received / Delivery	23.08	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHICK	5783	2023	1/3	



## Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.972/2023

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Ardita Haxhnikaj – Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi – Bajraktari, anëtarë; me Ardita Perçuki Shyti, Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional, si procesmbajtëse, sipas ankesës A.nr.972/2023, të datës 14.07.2023, të parashtruar nga ankuesi [redacted] a Peja, kundër organit të punësimit: Komuna e Pejës, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.08.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**Hedhet poshtë si e palejuar** ankesa me numër A.nr.972/2023, e datës 14.07.2023, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil, [redacted], (tutje referuar vetëm ankesja), i punësuar në Komunën e Pejës, më datë 14.07.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesë kjo e regjistruar me shenjën A. Nr. 972/2023, me pretendimin ankimor së kategorizimi i pozitës së ankuesit në klasën “Profesional 3” është bërë në shkelje të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 19.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pejës. Kjo e fundit, më datë 25.07.2023 ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Nga provat materiale konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Komunën e Pejës dhe se i njëjti sipas Akt Emërimit me Nr.01-112/01-0050530/18 të datës 04.05.2018, ushtron pozitën e punës “Zyrtar i ZKGJC I në z.v Leshan” në Drejtorinë për Administratë.

Më tej, nga shkresat e lëndës, rezulton së ankuesi ka realizuar koeficient pesë (5) të pagës-sipas sistemit të vjetër të pagave, ndërsa, në muajin shkurt 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesi është klasifikuar në klasën “Profesional 3”.

Ankuesi, më datë 14.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor që kategorizimi në klasën “Profesional 3” është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Në vlerësimin e ankuesit pozita e tij duhet të klasifikohet në klasën ‘Profesional 2’.

Për pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *”1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, ..... 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”*, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr. 10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik. Në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.*

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Pejës ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK), Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023. Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankuesit, për kategorizimin e pozitës së tij në kategorinë Profesional 2 është e parakohshme. Si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior. Rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuesit do t’i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër këtij vendimi të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS


Lënda me numër A.nr.972/2023.

Ardita Perouki Shyti

  
Procesmbajtëse



Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

